

## TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

- Emri i NSH-së:** **KBI "Agrokultura" Gjilan, PIP "Mladost" Gnjilane, Fi-670/89**  
("Ndërmarrja")
- Emri i Ndërmarrjes së Re:** **Ndër e Re Depoja Frigoriferi Shillovë Sh.P.K**  
("Ndërmarrja e Re")
- Vendndodhja:** Fshati Shillovë në Komunën e Gjilanit
- Biznesi/Sektori:** Industria Agro Ushqimore
- Prodhimet:** Shërbimi kryesor i ndërmarrjes është ruajtja në të ftohtë e mishit, frutave, perimeve dhe akulloreve. Objekti i depos frigoriferike përbëhet nga 6 dhoma frigoriferike, me vëllim total prej 12880m<sup>3</sup>. Temperatura mund të rregullohen ndaras për çdo dhomë.  
Depoja Frigoriferike po ashtu merrej edhe me përpunimin dhe paketimin e frutave dhe perimeve (qersh, kumbulla, kërpudha, speca, domate, luleshtrydhe, etj) për ruajtje në të ftohtë ose për shpërndarje.
- Tregu:** Treg i natyrshëm për Depon Frigoriferike janë agro-kombinatet dhe prodhuesit e mishit, frutave dhe perimeve në rajon. Depoja Frigoriferike po ashtu ka ofruar shërbime për klientët e vegjël në tërë Kosovën si qendër logjistike për distribuimin e mishit, akullores dhe frutave të importuara.
- Konkurrenca:** Depoja Frigoriferike është e vetmja e këtij lloji në pjesën lindore të Kosovës. Një e ngjashme është në Nish ( Serbi) dhe një me kapacitet të vogël në Prizren.
- Punonjësit:** Ndërmarrja për momentin ka 4 punëtorë. Sidoqoftë, asnjëri nga këta punëtor nuk do të bartet tek Ndër e Re.
- Ndërtesat dhe tokat:** Kjo ofertë do të ofrojë mundësi të shkëlqyeshme për të blerë një objekt njëkatësh 4322m<sup>2</sup>, si dhe tokën përcjellëse 9878m<sup>2</sup>, që së bashku përfshinë një sipërfaqe të përafërt prej 14200m<sup>2</sup> (1ha 42ari 00m<sup>2</sup>). Lokacioni është mjaft i përshtatshëm për zhvillim të çdo lloj biznesi.
- Detyrimet që do të barten:** (1) Detyrimet neto të NSH-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjobat, të cilat janë krijuar gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;  
(2) Detyrimet e papaguara të NSH-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

ri;

- (3) Detyrimet e NSh-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë krijuar gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (4) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve ( duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:
  - a) Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyrë në fuqi;
  - b) Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSH-së.

**Fotoja e  
Ndërmarrjes së Re**

**Ndër e Re Depoja Frigoriferi Shillovë Sh.P.K**



Departamenti i Shitjes

**Informatat:**

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +381 (0) 38 500 400 -1255

Fax: + 381 (0) 38 248 076

[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

**Dokumentet e  
Ofertimit:**

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rr. Ilir Konushevci Nr.8

10000 Pristinë, Kosovë

Rr. E Bujanovcit PN  
(f-ika baterive IBG)  
60 000 Gjilan, Kosovë,  
Tel: 0280 328 444,  
Fax: 0280 326 000  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)